

Raporti Vjetor 2023

**Rrjeti Shqiptar për
Zhvillimin Rural**



ANRD

ALBANIAN NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT
RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

Raporti Vjetor 2023

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

VIZIONI YNË

Vizioni ynë afatgjatë “Europa në Shqipërinë Ruale” fokuson përpjekjet tona për t’u shndërruar në një aktor të rëndësishëm që shtyn përpara procese dhe reforma që avancojnë interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale dhe përshpejtojnë këto procese drejt modeleve dhe praktikave pozitive evropiane për një Shqipëri me komunitete rurale të gjallëruara, përfshirëse, pjesëmarrëse, aktive dhe kontribuese për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës.

MISIONI YNË

Formësimi i një zëri të qartë, efektiv e të qëndrueshëm në mbështetje të komuniteteve rurale sipas filozofisë së zhvillimit rural të udhëhequr nga komuniteti.

PARIMET e promovuara nga ANRD janë të bazuara në praktikën e mira evropiane:

- o Zhvillimi i qëndrueshëm rural social dhe ekonomik, me bazë territorin dhe veçantitë specifike të tij, duke aktivizuar komunitetet e mbetura pas në proceset e zhvillimit përmes qasjes nga poshtë-lart që fuqizon aktorët dhe rrit pjesëmarrjen e tyre;
- o Qasja e integruar ndërsektoriale dhe shumë aktorësh në dobi të zhvillimit rural, përmes rrjetëzimit, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të partneriteteve lokale duke shfrytëzuar idetë inovative;
- o Financimi dhe menaxhimi i projekteve lokale nga burime të ndryshme financiare si kontribut dhe konfirmim i kredibilitetit dhe rëndësisë së projekteve lokale.

Mos kini frikë të shembni muret që bëhen pengesë në rrugën tuaj, ashtu sikurse Liljana bëri. Guximi juaj mund të hapë rrugën për fuqizimin e vajzave dhe grave në zonat rurale. Dhe, në qoftë se doni të arrini diçka duhet shumë punë, vullnet dhe sakrificë. Asgjë nuk të jepet falas në këtë jetë, gjithçka fitohet.

Pavlina Sumbulla,
Fituese e çmimit “Liljana Isakaj” Për Lidërsip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale

"Zonat rurale karakterizohen nga një sërë sfidash që duhen adresuar për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së komuniteteve rurale. Zhvillimi i zonave rurale është një proces kompleks që kërkon një qasje holistike dhe të integruar dhe është i lidhur ngushtë me fuqizimin e fermerëve të rinj."

Mateo Bartolini, Zëvendës President i Cia – Agricoltori Italiani

“Falë Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe organizatave të saj anëtare e gjejmë veten në një mjedis sa fuqizues dhe stimulues, një hapësirë ku flasim për shqetësimet dhe zgjidhjet për fuqizim të grave dhe vajzave në zonat rurale. Jemi të drejtuar nga vetëdija që duhet të luftojmë për barazinë gjinore në zinxhirët e vlerave. Nëse nuk e bëjmë këtë do të përkeqësojmë përfshirjen sociale dhe ekonomike.”

Stefania Vizzaccaro, Drejtore e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim

“Jemi këtu sot, jo vetëm si advokues, por edhe si forcë shtytëse e zhvillimit rural. Këtu sot, gjendet zemra e zhvillimit rural të Shqipërisë, përfaqësues të ndryshëm të institucioneve, strukturave, grupeve dhe komuniteteve rurale në gjithë Shqipërinë. Të gjithë ne jemi pjesë e së tërës, jemi mozaik perspektivash të ndryshme, çka do të na mundësojë të diskutojmë çështjet më kritike me të cilat përballen zonat rurale. Ky është parlamenti i të gjithëve. Askush të mos mbesë pas, kjo thënie në zhvillimin rural merr një rëndësi të veçantë duke ditur që në masë të madhe komunitete rurale nuk janë të lidhura me proceset dhe dinamikat ku drejtimet kryesore, vendime që influencojnë jetën e tyre rrihen, diskutohen dhe merren.”

Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural

Mesazh nga Kryetari i Bordit

Të dashur lexues,

Leximi i raportit vjetor të Rrjetit Kombëtar për Zhvillimin Rural të sjell një moment kënaqësie për ecurinë dhe arritjet. ANRD tashmë ka hyrë në vitin e nëntë të funksionimit të vet dhe me krenari vërejmë se ANRD demonstroi të gjitha cilësitë e një organizate ombrellë të besueshme, përfaqësuese dhe të mirë vendosur midis të gjithë aktorëve publik dhe jo-publike që janë të angazhuar në zhvillimin e qëndrueshëm rural të vendit tonë.

Raporti i prezantuar për vitin 2023 dëshmon se ANRD po konsolidon strukturën e vet organizative me një numër gjithnjë në rritje të organizatave anëtare, me shtrirje gjeografike dhe me prezencë fizike përmes projekteve në të gjithë vendin. Gjithashtu, Raporti jep evidencë të përpjekjeve të ANRD për të angazhuar sa më shumë anëtarësinë në realizimin e objektivave dhe misionit të vet, dhe gradualisht po merr atributet e një qendre burimore për të rinjtë, gratë, OSHC-të lokale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për një zhvillim të qëndrueshëm rural për sa i përket çështjeve të zhvillimit të integruar rural, aktivizimit rinor në zonat rurale, fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i barazisë gjinore në bujqësi dhe zhvillimit rural, sistemet e qëndrueshme ushqimore etj.

Rrjeti Kombëtar për Zhvillimin Rural tashmë prej vitesh demonstroi një angazhim serioz jo vetëm në përfaqësimin e komuniteteve vendore, fermerëve, blegtorëve dhe organizatave të ndryshme duke përcjellë në instancat më të larta të vendimmarrjes dhe qeverisjes zërin nga poshtë të shoqërisë, veçanërisht të grupeve më të cenueshme, për politika efektive, mbështetje, rrjetëzim dhe inkurajim të aktorëve të ndryshëm në komunitet. Nga ana tjetër, përmes deklaratave publike dhe pjesëmarrjes në struktura të ndryshme të dialogut, ANRD ka reaguar për çdo aspekt të qeverisjes dhe vendimmarrjes që nuk mbështetet dhe nuk pasqyron nevojat dhe prioritetet reale të shoqërisë. E gjithë kjo për ndihmuar në krijimin e një partneriteti efektiv afatgjatë ndërmjet qeverisjes së sektorit dhe komuniteteve vendore, çka është elementi thelbësor për zhvillimin e

qëndrueshëm rural.

Zhvillimi deri më sot i ANRD-së, autoriteti publik që ka demonstruar dhe konsolidimi i mëtejshëm i rolit të saj është mbështetur mbi të gjithë në punën, përvojën dhe identitetin e organizatave anëtare të veta, të cilat rriten vazhdimisht. Mes shumë cilësish, vlen të dallohet që Rrjeti ynë nuk mbështet klientelizmin, por meritokracinë në avancimin e vazhdueshëm të agjendës së vet duke ftuar krahas të tjerash edhe organizata të tjera simotra në rajon dhe më gjerë, në nivel evropian.

Puna dhe arritjet e deritanishme reflektohen edhe në zgjerimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të ANRD me donatorë të ndryshëm, roleve drejtuese në konsorciume zbatuese të projekteve të ndryshme dhe partneriteteve të ndryshme të ANRD me akademinë dhe platforma të ndryshme në zhvillimin e qëndrueshëm rural të tjera.

Jeni të inkurajuar për të gjetur këto vlerësime përgjatë shfletimit të Raportit vjetor 2023.

Sotiraq Hroni

Kryetar i Bordit Ekzekutiv

Mesazh nga Koordinatorja Kombëtare

Të nderuar anëtarë të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, kolegë, partnerë dhe mbështetës të punës sonë,

Prej vitesh, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural është përpjekur të jetë zëri i komuniteteve rurale. Nga viti në vit, kemi rritur aktivitetin tonë dhe jemi bërë një aktor i rëndësishëm mes shumë aktorëve institucionalë të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale. Ky raport përpiqet të prezantojë përmbledhtas punën tonë, momentet kyçe të përpjekjeve tona, partneritetet dhe arritjet kryesore të vitit 2023.

Fillimi i projektit rajonal *‘Akademia nga Ferma në Tryezë, për një Ballkan Perëndimor’* shënoi një nisje entuziaste të vitit 2023. Në rolin si palë përgjegjëse për UN Women Albania, kemi vijuar përpjekjet tona për fuqizimin e grave dhe vajzave nga zonat rurale në bashkitë e Elbasanit dhe Leskovikut. Gjithashtu, fuqizimi i të rinjve nga zonat rurale mbetet një nga prioritetet tematike të rëndësishme për ANRD. Gjatë vitit të shkuar, përmbyllëm përpjekjet për konsolidimin e Qendrës së Rinisë Rurale me regjistrimin ligjor të saj si organizatë jo-fitimprurëse. Ky moment i rëndësishëm u pasua nga anëtarësimi i Qendrës në Rrjetin Evropian të Rinisë Rurale (Rural Youth Europe) dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të Qendrës në disa aktivitete ndërkombëtare. Njëkohësisht, kjo tematikë përfaqëson një sfidë të re për ANRD në të ardhmen lidhur fuqizimin dhe rritjen e përpjekjeve të Qendrës në proceset zhvillimore.

Gjatë këtij viti, kemi vazhduar me nismat tona të përbashkëta me organizatat anëtare të ANRD, duke nxitur ndërveprimin dhe forcuar kohezionin brenda anëtarësisë së ANRD. ‘Rinia Rurale Shqiptare’, ‘Ruralbania’, ‘Liqenet e Shqipërisë’, ‘Toka Jonë’ janë disa prej projekteve të përbashkëta që po zbatojmë me organizata anëtare të ANRD dhe partnerë të tjerë.

ANRD ka vazhduar promovimin dhe mbështetjen e zbatimit të qasjes Leader, animimin e proceseve me pjesëmarrje për krijimin e Grupeve Vendore të Veprimit, formulimin me pjesëmarrje të strategjive lokale të zhvillimit, si dhe ofrimin e mbështetjes për GVV-të në zbatimin e nismave lokale për animimin dhe përvetësimin e njohurive në komunitetet vendore.

Përmes mbështetjes së UN Women Albania dhe GIZ, kemi arritur të mbështesim katër GVV në disa bashki të vendit: Elbasan, Kolonjë, Pogradec dhe Vlorë. ANRD mbetet e dedikuar të investojë në ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm për të orientuar zhvillimin e qëndrueshëm rural përmes zbatimit të qasjes Leader.


Parlamenti i 3-të Rural Shqiptar shënon momentin kulminant të përpjekjeve tona të përbashkëta advokuese për përmirësimin e cilësisë së jetës të banorëve të komuniteteve rurale. Pjesë integrale e këtij eventit kombëtar ishte Asambleja e Parë e të Rinjve në Zonat Rurale dhe Edicioni i V-të i “Pro Grave Rurale”. Ne besojmë fort në rolin e Parlamentit Kombëtar Rural si një instrument i rëndësishëm për të avancuar demokracinë vendore, përfshirjen sociale dhe për të nxitur progresin në integrimin evropian dhe arritjen e objektivave globale të OKB-së.

Në emër të anëtarësisë së ANRD, bordit dhe stafit, dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e mia për të gjithë partnerët, bashkëpunëtorët dhe mbështetësit e punës sonë për inkurajimin, mbështetjen dhe ndihmën e ofruar gjatë gjithë vitit, pa të cilat nuk do të ishin të mundura arritjet, sado të vogla, të punës sonë.

Me respekt dhe mirënjohje,

Evelina Azizaj

Shifra dhe Fakte 2023



AKTIVITETE 2023

Inagurimi i Qendrave të Zhvillimit të Artizanatit në bashkitë Kavajë dhe Krujë

Në përpjekje për të fuqizuar ekonomikisht gratë e përfshira në zinxhirin e vlerës së artizanatit në bashkitë e Krujës dhe Kavajës, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural, me mbështetje të UN Women Albania, përmes Projektit me Ndjeshmëri Gjinore për Rikuperimin dhe Rindërtimin pas Tërmetit, me fonde të qeverisë suedeze përmes Fondit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, ka bërë të mundur [krijimin dhe funksionimin e Qendrave të Zhvillimit të Artizanatit](#) në këto dy bashki. Në shkurt 2023 ANRD së bashku me bashkitë përkatëse, gratë anëtare të grupit lokal të artizaneve dhe me përfaqësues të UN WOMEN inaguroi hapjen e qendrave dhe lançimin e websitet www.artizanetekrujes.al. Këto qendra ofrojnë ambient pune të përbashkët për gratë artizane, anëtare të dy grupeve lokale të artizaneve. Qendrat do të ndihmojnë në përmirësimin e mjeshtrive të artizanatit lokal tradicional, transferimin e njohurive dhe aftësive tek brezi i ri, përmirësimin e aftësive teknike të artizaneve, si dhe në ofrimin e mundësive për aktivitete shkëmbyese, promovimin e produkteve dhe përmirësimin e marketimit. Kjo ndërhyrje synon të sjellë ndikim pozitiv në aspektin ekonomik dhe social të grave të angazhuara në këtë aktivitet, duke ruajtur në të njëjtën kohë zejet tradicionale dhe trashëgiminë kulturore të vendit.

Startimi i projektit rajonal “Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin të Gjellbër – E ardhmja jonë e përbashkët evropiane” – 16 janar 2023

Fillimi i vitit 2023 shënoi zbatimin e projektit rajonal katërvjeçar “[Akademia nga Ferma në Tryezë për një Ballkan të Gjellbër – E ardhmja jonë e përbashkët evropiane](#)”, mundësuar me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian, në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroaci. Në shkurt dhe mars u zhvilluan dy takimet e para të stafit rajonal që në udhëheqjen e ANRD do të zbatojnë projektin në katër vitet e ardhshme (Janar 2023 – Janar 2027). Më 23 mars në Tiranë u zhvillua takimi i parë i projektit, i cili bëri bashkë përfaqësuesit e Rrjeteve Kombëtare për Zhvillim Rural nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroacia si dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të projektit, të tillë si Delegacioni i BE-së në Tiranë, UBT, TACSO etj. Përgjatë dy ditëve intensive planifikimi dhe diskutimi ekipi ndjehet më i përgatitur për zbatimin e

aktiviteteve në nivel rajonal dhe kombëtar dhe për adresimin e sfidave në katër vitet e ardhshme. Viti 2023, viti i parë i zbatimit të projektit përfshiu planifikim dhe angazhimin e [ekipit të ekspertëve](#) për përgatitjen e moduleve të trajnimit të Akademisë nga Ferma në Tryezë dedikuar përfaqësuesve të sektorit të shoqërisë civile. Ky shënoi fillimin e një faze sa sfiduese aq edhe kyçe në misionin tonë për kontribuar në zbatimin e proceseve të rëndësishme, sikurse është agjenda e gjelbër.

Takimi vjetor i Asamblesë së Përgjithshme të ANRD- 7 prill 2023

Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural [u mbledh më](#) 7 prill 2023 duke sjellë përfaqësuesit e organizatave anëtare për të rishikuar arritjet e vitit të kaluar dhe diskutuar veprimet për të ardhmen. Disa nga momentet kyçe të agjendës së takimit përfshijnë prezantimin dhe aprovimin [e raportit vjetor](#) të vitit të kaluar, shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave të reja për anëtarësi, diskutimin mbi Parlamentin e tretë rural shqiptar dhe platforma të tjera të advokocasisë rinore dhe të grave rurale. Tre organizata të reja iu bashkuan ANRD si anëtare me të drejta të plota. Diskutimi mbi Parlamentin e Tretë Rural Shqiptar ishte çështja kryesore e diskutimeve. Asambleja vendosi që Parlamentit i tretë rural shqiptar të zhvillohet në vjeshtën e 2023, me moton ‘Jeta buron nga fshati’. Në vijim të diskutimit Asambleja e Përgjithshme miratoi [Deklaratën e Asamblesë](#) për të informuar partnerët, bashkëpunëtorët dhe entuziastët e punës tonë mbi Parlamentin e tretë rural shqiptar.

Konsolidimi i Qendrës së Rinisë Rurale si një platformë funksionale drejt proceseve dhe politikave të orientuara drejt rinisë - janar-maj 2023

Në vijim të përpjekjeve tona për konsolidimin e Qendrës së Rinisë Rurale, 35 anëtarët më aktivë të vet [u mbledhën në janar](#) të bindur dhe të sigurt në rrugën drejt formalizimit ligjor të grupit të tyre si organizatë jo-qeveritare. Ky takim i rëndësishëm shërbeu për zgjedhjen e strukturave të brendshme të organizatës. Takimi u pasua [me përgatitjen dhe dorëzimin në gjykatë](#) të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin ligjor të RYH. Në maj të vitit të shkuar përmbyllim një pjesë të rëndësishme të rrugëtimit të konsolidimit të Qendrës së Rinisë Rurale me regjistrimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Ky hap shënon një moment kyç në përmbushjen e misionit të RYH për angazhimin në një dialog të strukturuar në

proceset e politikë bërjes dhe vendimmarrjes në lidhje me çështje që ndikojnë mirëqenien e komuniteteve rurale. Mbetemi të bindur se Qendra e Rinisë Rurale do të fuqizojë zërin e të rinjve në zonat rurale dhe lidhshimin e tyre në të gjitha nivelet duke kontribuar aktivisht në zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe përmirësimin e situatës socio-ekonomike të komuniteteve rurale.

Pjesëmarrja e ANRD dhe RYH në Parlamentin e parë Rural të Malit të Zi- Maj 2023

Përfaqësues të ANRD dhe RYH morrën pjesë në [Parlamentin e parë Rural të Malit të Zi](#), i cili u zhvillua në Nikshiq në datat 15-16 maj. Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj, ishte ftuar si paneliste në panelin me temë 'Heroinat e padukshme të zonave rurale'. Kjo përvojë ishte një mundësi e jashtëzakonshme për të ndarë ide dhe mendime të fituara nga angazhimi i ANRD me gratë në zonat rurale para një audience të larmishme. Eventu ishte një mundësi e shkëlqyer për t'u lidhur me gra nga rajoni dhe për të ndarë një mendësi të përbashkët në lidhje me pabarazitë gjinore në bujqësi dhe zhvillimin rural, si dhe për të identifikuar veprimet që duhen ndërmarrë nga qeverisja në nivel qendror dhe lokal, organizatat e shoqërisë civile, dhe aktorë të tjerë. Një tjetër çështje me shumë interes ishte pjesëmarrja e të rinjve në zbatimin e qajës LEADER dhe se në ç' mënyrë pjesëmarrja aktive e të rinjve në Grupet Vendore të Veprimit do të krijojë mundësi për ta bërë zërin e tyre më të fortë në adresimin e problematikave të zhvillimit rural.

Pjesëmarrja në Parlamentin e 3-të Rural Ballkanik dhe Samiti i Ushqimit- Mostar 12-15 Qershor

Një delegacion prej 13 pjesëmarrësish nga Shqipëria, ndër të cilët Koordinatorja Kombëtare e ANRD dhe dy përfaqësues të Qendrës së Rinisë Rurale ishin pjesë e aktiviteteve të planifikuara gjatë [Parlamentit Rural Ballkanik në Bosnje-Hercegovinë](#). Kjo ngjarje iu ofroi pjesëmarrësve një mundësi të shkëlqyer për rrjetëzim, shkëmbim njohurish, diskutimin e prioriteteve të përbashkëta në lidhje me sfidat dhe nevojat prioritare në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm rural në rajon. Me fokus në sfidat e zbatimit të qajës LEADER të BE-së, zbatimin e Agjendës së Gjelbër për vendet e Ballkanit Perëndimor, sigurinë ushqimore dhe gastronominë rurale, si dhe mundësitë dhe sfidat për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale, Parlamenti synoi të

përfaqësojë dhe të promovojë vetë-aktivizmin e banorëve të komuniteteve rurale. Synimi afatgjatë është i këtij eventi është që nevojat dhe interesat e komuniteteve të reflektohen në politikat e zhvillimit rural dhe të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm për zonat rurale në Ballkanin Perëndimor.

Pjesëmarrje në Kampin Rajonal për të Rinjtë Rural në Vuçje, Mal të Zi,- 27-31 gusht 2023

Përfaqësues të Qendrës së Rinisë Rurale (RYH) morën pjesës në edicionin e [6 të Kampit Rajonal për të Rinjtë nga Zonat Rurale](#). Ky aktivitet u zhvillua në Mal i Zi dhe mblodhi së bashku 30 pjesëmarrës nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Kampi i këtij viti u fokusua në zgjerimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për zhvillimin e komuniteteve rurale dhe nxitjen e dëshirës së të rinjve për të qenë animatorë të komuniteteve të tyre. Në fund të këtij kampi pjesëmarrësit zgjeruan njohuritë e tyre në lidhje me teknikat e përdorura për njohjen e nevojave të komunitetit, mirëmenaxhimin e burimeve, si natyrore ashtu dhe njerëzore, të zonave rurale për një zhvillim rural të qëndrueshëm.

Punëtorja "Agroekologjia si përgjigje ndaj ndryshimeve klimatike dhe përfitimet për fermerët"- 16 shtator 2023

Përmes bashkëpunimit me Schola Campesina, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural organizoi më 16 shtator 2023 punëtorinë “Agroekologjia si përgjigje ndaj ndryshimeve klimatike dhe përfitimet për fermerë”. Në këtë punëtori ishin pjesëmarrës 13 të rinj, anëtarë të Qendrës së Rinisë Rurale të cilët përfaqësonin pesë zona të ndryshme rurale: Fushë Arrëz, Pogradec, Maliq, Kukës dhe Durrës. [Ky aktivitet](#) kishte për qëllim përmirësimin e njohurive të të rinjve nga zonat rurale mbi potencialet e agroekologjisë për të zbutur ndikimin e ndryshimeve klimatike në bujqësi. Prezantimet teorike u ndërthuren me punë në grupe, ku të rinjtë identifikuan sfidat në nivel lokal për aplikimin e agroekologjisë dhe mundësitë për aplikimin e saj. Në vijim u prezantua [platforma Bilim](#), një hapësirë për ndarjen e përvojave dhe njohurive në lidhje me zhvillimin rural të qëndrueshëm.

Parlamenti i 3-të Rural Shqiptar”- 11-13 tetor 2023

Më 11-13 tetor, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe 34 organizatat anëtare të veta në partneritet me Universitetin

Bujqësor të Tiranës, sollën së bashku më shumë se 500 pjesëmarrës nga komunitete të ndryshme rurale të Shqipërisë dhe aktorë të rëndësishëm të zhvillimit rural për të diskutuar sfidat dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerren për përmirësimin e mirëqenies së banorëve të zonave rurale. [Parlamenti i tretgë kombëtar rural](#) përfaqëson përpjekjen më të qëndrueshme të advokacisë nga poshtë-lart, duke krijuar hapësirë për dialog dhe bashkëpunim, shkëmbim të këndvështrimeve rreth çështjeve të rëndësishme dhe aktuale të zhvillimit rural dhe bujqësor, si dhe për të ofruar rekomandime për gjallërimin e jetës dhe ekonomisë rurale.

Edicion i tretë erdhi me temën “Jeta buron nga fshati”, e cila thekson të vërtetën e madhe se zhvillimi dhe përparimi i Shqipërisë vjen nga zonat e saj rurale. “Jeta buron nga fshati” thekson rëndësinë e mbështetjes së ekonomive rurale, investimit në infrastrukturë, arsim dhe krijimit të mundësive për të rinjtë brenda komuniteteve të tyre. Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale mund të bëhet vetëm duke punuar me të gjithë elementët përbërës të këtyre zonave, prandaj në këtë edicion kjo platformë ishte gjithëpërfshirëse, duke krijuar për herë të parë mundësi për të rinjtë nga zonat rurale, fermerët e rinj dhe sipërmarrësit të mblidhen në Asamblenë e tyre Rinore: “Me të rinjtë, për të rinjtë, nga vetë të rinjtë”. Gjithashtu, Edicioni i 5-të i Pro-Grave rurale 2023 u organizua në kuadër të Parlamentit Rural për të fuqizuar advokacinë për një sektor bujqësor dhe rural, për komunitetet dhe një shoqëri me mundësi të barabarta për të gjithë.

Asambleja e parë e të Rinjve në Zonat Rurale - 11 tetor 2023

Në vazhdim të përpjekjeve tona të përbashkëta për të ndikuar në politikat e sektorit të bujqësisë me qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm rural dhe për të vlerësuar rolin dhe nevojën e të rinjve në zonat rurale, më 11 tetor 2023 u mbajt [Asambleja e parë Kombëtare e të Rinjve nga Zonat Rurale](#) nën moton “*Me të rinjtë, për të rinjtë, nga vetë të rinjtë*”. Në këtë asamble të parë morën pjesë më shumë se 100 të rinj nga të gjitha zonat rurale të Shqipërisë, të cilët ndanë sfidat me të cilat ata përballen dhe aspiratat e tyre për të ardhmen

Edicioni i V-të ‘Pro Grave Rurale’: Gratë rurale kultivojnë ushqim cilësor për të gjithë - 12 tetor 2023

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), në bashkëpunim me

organizatat anëtare, organizoi me sukses [Edicionin e V-të ‘Pro Grave Rurale’](#) më 12 tetor 2023 në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës në kuadër të Parlamentit të tretë Rural Shqiptar. Takimi i përvitshëm i ‘Pro- Grave Rurale’ synon të nxisë solidaritetin mbarëshoqëror për fuqizimin e grave dhe vajzave në zonat rurale, si dhe të sensibilizojë publikun mbi nevojën e mbështetjes së qëndrueshme për adresimin e sfidave me të cilat ndeshen gratë rurale në vendin tonë, duke vënë theksin në barazi dhe drejtësi sociale.

Ky edicion bëri bashkë më shumë se 150 pjesëmarrës, kryesisht grupe të grave dhe vajza që udhëtuan nga komunitete rurale të vendit si Erseka, Elbasani, Puka, Malësia e Madhe, Shkodra, Pogradeci, Lushnja, Berati etj, të cilat së bashku me përfaqësues nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, FAO, UN Women, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucione të tjera të qeverisjes qendrore, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural, Universiteti Bujqësor i Tiranës, organizata të ndryshme të shoqërisë civile, të rinj, përfaqësues të vetëqeverisjes vendore etj., diskutuan mbi sfidat dhe prioritetet e grave dhe vajzave në zonat rurale si dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të përmirësuar mirëqenien e tyre, në veçanti rolin e grave në zinxhirët e vlerës në sektorin agro-ushqimor.

Trajnimi: Strategjitë e advokimit për të rinjtë në zhvillimin rural - 11-14 tetor 2023

Të rinjtë e Qendrës së Rinisë Rurale morën pjesë në trajnimin mbi [Strategjitë e Advokimit për të Rinjtë në Zonat Rurale](#). Trajnimi kishte për qëllim përforcimin e kapaciteteve advokuese dhe përfaqësimit të interesave të anëtarëve të RYH në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar. Trajnimi u ofrua nga Z. Mateo Bartolini, Zëvendës President i [Cia – Agricoltori Italiani](#), një nga organizatat më të mëdha të fermerëve të rinj në Itali. Trajnimi u fokusua në tema si çfarë është advokacia, proceset e zhvillimit të politikave rurale, analizën e politikave publike, strategjitë efektive të advokimit dhe komunikimit.

Zbatimi i qasjes LEADER në bashkitë e Elbasanit, Kolonjës, Shkodrës, Pogradecit dhe Vlorës

Përgjatë vitit 2023 ANRD ka treguar përkushtim në zbatimin e qasjes LEADER si një nga instrumentet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm rural bazuar në parimin e pjesëmarrjes nga poshtë lart. Falë mbështetjes financiare të disa programeve të donatorëve të ndryshëm, ANRD është angazhuar në ofrimin e asistencës teknike në krijimin dhe mbështetjen

e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV).

Projekti “Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi” mbështetur nga UN Women

ANRD në rolin e nënkontraktorit të UN Women dhe në bashkëpunim me bashkitë e Kolonjës dhe Elbasanit ka asistuar krijimin dhe themelimin e dy GVV-ve, konkretisht GVV “Kolonja e Gjelbër” dhe GVV “Egantia”. Procesi i krijimit të GVV-së, mobilizimit të komuniteteve lokale dhe hartimit të Planeve të Zhvillimit Lokal për dy zonat Leader ka qenë intensiv dhe dinamik. Kjo për të siguruar një proces gjithëpërfshirë, transparent dhe me pjesëmarrjen e gjithë aktorëve dhe komuniteteve të ndryshme të zonës. Janë organizuar shumë takime, ditë informuese, krijimin e partneriteteve lokale, seminare dhe trajnime mbi [planifikimin strategjik dhe menaxhimin e projekteve](#), organizimin e panireve të ideve, diskutime në forma të ndryshme dhe analizën SWOT të zonave që mbulon secila nga Grupet Vendore të Veprimit. Procesi ka ndihmuar në përmirësimin e kapaciteteve të anëtarëve të GVV-ve, duke i aftësuar për të përmbushur rolin e tyre në strukturat e GVV-së dhe në komunitetin rurale, si dhe mbledhjen e kontributeve të nevojshme për hartimin e Strategjive të Zhvillimit Vendor.

Projekti rajonal i GIZ-it “SEDRA II” dhe zbatimi i qasjes Leader

Me mbështetjen e projektit rajonal “SEDRA II” të zbatuar nga GIZ, ANRD po ndihmon dy Grupe Vendore Veprimi në lidhje me përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit Lokal, specifikisht GVV “Mokër-Gorë” në bashkinë e Pogradecit dhe GVV “Vjona” në bashkinë e Vlorës. Në Pogradec përmes metodës së "Panairit të Ideve", komunitetet vendore [në Proptisht dhe Buzahishtë](#) reflektuan mbi pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet, duke përfshirë nevojat e zhvillimit vendor si bazë për formulimin e strategjisë. Nga ana tjetër në Vlorë, ANRD zhvilloi [workshope me përfaqësues të GVV "Vjona"](#) dhe anëtarë të komunitetit mbi planifikimin e zhvillimit vendor të integruar, duke përfshirë një analizë të aseteve të zonës dhe për të krijuar një skicë për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Lokal. Procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës siguron që strategjitë e zhvillimit lokal të reflektojnë nevojat dhe prioritetet e komunitetit.

Projekti “Liqenet e Shqipërisë” dhe zbatimi i qasjes Leader për zhvillimin e turizmit të përgjegjshëm

Në rolin e organizatës partnere të konsorciumit të gjerë italo-shqiptar, me fonde të qeverisë italiane, ANRD po ofron

ekspertizë teknike në krijimin e dy GVV-ve në zonat përreth dy liqeneve, Shkodrës dhe Pogradecit. Aktualisht, janë zhvilluar proceset e formimit të [GVV-së “Labeatët”](#) në Shkodër dhe Malësi e Madhe, dhe GVV [“Lyhnidas” në Pogradec](#). Përgjatë 2023 janë zhvilluar disa takime dhe punëtori ndër të cilat takime të grupit të punës me përfaqësues dhe aktorë të ndryshëm (institucione, organizata, operatorë ekonomikë) që veprojnë në këto territore, për të diskutuar e bashkëndarë ide sa i takon hartimit të një Plani Veprimi me pjesëmarrje për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Liqenin e Shkodrës dhe Pogradecit.

Tabela 1. Të dhëna mbi GVV-të e mbështetura nga ANRD gjatë vitit 2023

GVV dhe udhëheqësit e procesit	Programi/Donatorët	Nr. anëtarëve në Asamble/ Bord	Zona Leader	Popullsia e zonës Leader
<u>GVV Kolonja e Gjellbër</u> me udhëheqjen e shoqatës Agrinas Ersekë	UN Women, Projekti GREAT	26 anëtarë/9	Territori i bashkisë Kolonjë/8 njësi administrative	11,100 banorë
<u>GVV Egnatia</u> me udhëheqjen e bashkisë dhe Federatës Bujqësore të Elbasanit	UN Women/ Projekti GREAT	31 anëtarë/9	Territori i bashkisë Ebasan me përjashtim të qytetit të Elbasanit/ 12 njësitë administrative dhe lagje nr.3	110,900 banorë
<u>GVV Labeatët</u> me udhëheqjen e organizatës VIS Albania	AICS/Projekti Liqenet e Shqipërisë	47 anëtarë/11	Territori i bashkive Shkodër dhe Malësi e Madhe (duke përjashtuar qytetin e Shkodrës)	149,000 banorë
<u>GVV LYHNIDAS</u> me udhëheqjen e organizatës COSV	AICS/Projekti Liqenet e Shqipërisë	35 anëtarë /11	Territori i bashkisë Pogradec që përfshin 4 njësi administrative: Pogradec, Bucimas, Cerravë dhe Udenisht.	75,000 banorë
<u>GVV MOKËR GORË</u> me udhëheqjen e Shoqatës “Shoqata e Përdoruesve të Burimeve Natyrore Velçan	GIZ, Projekti SEDRA II	24 anëtarë/7	Territori i bashkisë Pogradec që përfshin 4 njësi administrative: Velçan, Trebinjë, Proptisht dhe Dardhas.	16,500 banorë
<u>GVV VJONA</u> me udhëheqjen e nënkryetares së bashkisë Aulona Veizi	GIZ, Projekti SEDRA II	/7	Territori i bashkisë Vlorë që përfshin dy njësi administrative: Qendër dhe Novoselë.	36,000 banorë

Fuqizimi i vajzave dhe grave në zonat rurale

Aktivitete të lidhura me fuqizimin e grave dhe vajzave në zonat rurale kanë qenë në fokus të vitit të kaluar. Me mbështetjen e UN Women, përmes projektit “[Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi](#)” ANRD ka vazhduar përpjekjet e fuqizimit e social ekonomik të grave të angazhuara në sektorin e bujqësisë. ANRD ka mbështetur dy grupe të grave lokale (28 gra), në Njësinë Administrative Shirgjan (Bashkia Elbasan) të angazhuara në sektorin e perimeve dhe Njësisë Administrative Leskovik (Bashkia Kolonjë) të përfshira në prodhimin e zahireve të dimrit, për zhvillimin e kapaciteteve të tyre sipërmarrëse.

[Pesë module trajnimi](#) mbi sipërmarrjen, marketingun, standardizimin e produkteve të freskëta dhe të përpunuara, cikli i prodhim-riprodhimit dhe kontabiliteti i fermave si nevojë për ngritjen e kapaciteteve u zhvilluan me grupet lokale të grave në Shirgjan dhe Leskovik si përgjigje ndaj nevojave për trajnim të identifikuar më herët.

Gjithashtu janë zhvilluar [dy evente rrjetëzimi](#) dhe panairi “Shije Fshati” me përfaqësuese nga grupet lokale të grave në Leskovik dhe Shirgjan me qëllim shkëmbimin e informacion në çdo fazë të zhvillimit të biznesit të fermës si edhe për të vendosur bashkëpunim dhe ndërveprim midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë të zinxhirit të vlerave.

PUBLIKIME 2023

Deklaratë e Asamblesë së Përgjithshme së ANRD: Parlamenti i Tretë Rural Shqiptar 2023

Më 7 prill 2023, tridhjetë e katër organizatat anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, njoftuan fillimin e përgatitjeve për Parlamentin e tretë Kombëtar Rural për t’u mbajtur në datat 11-13 tetor 2023.

Parlamenti i tretë rural shqiptar – platforma kombëtare dedikuar ngritjes së kapaciteteve, rrjetëzimit dhe advokacisë për zhvillimin e qëndrueshëm rural – u planifikua të organizohet më 11-13 tetor 2023 në iniciativën e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe 34 organizatat anëtare të tij. Kjo platformë përfaqëson përpjekjen më të qëndrueshme të advokacisë nga poshtë-lart duke krijuar hapësirën e duhur për dialog dhe bashkëpunim, shkëmbim dhe diskutimin e çështjeve të rëndësishme dhe aktuale të zhvillimit rural dhe bujqësor si dhe ofrimin të rekomandimeve për rivitalizimin e jetës dhe ekonomisë rurale. [Deklarata e Asamblesë për Parlamentin e Tretë Rural Shqiptar 2023](#) u dakortësua në përfundim të takimit vjetor të Asamblesë së përgjithshme të ANRD 2022.

Raporti Vjetor 2022 i Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural

[Raporti Vjetor 2022](#) i Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural ofroi një pasqyrë të gjerë të progresit dhe sfidave të vitit të kaluar. Ky raport paraqiti progresin e projekteve dhe programeve që ANRD po zbaton në lidhje me zhvillimin rural të qëndrueshëm. Nga ana tjetër dimensionin financiar i përfshirë në raport ofroi një vështrim të qartë në shpenzimet e bëra për të realizuar aktivitetet dhe eventet tona gjatë vitit 2022. Raporti u miratua nga Asambleja e Përgjithshme më 07 Prill 2023.

Mozaik i jetës rurale – Album fotografik dedikuar grave në zonat rurale - 13 prill, 2023

Jeta e grave në zonat rurale është si një mozaik me pjesëza, ku gratë dhe vajzat marrin shumë role. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural sjell për herë të parë një album fotografik dedikuar grave kampione në sektorin agro-ushqimor, duke synuar të ofrojë një vështrim të kontributit të tyre në jetën social-ekonomike të Shqipërisë rurale. [Albumi](#) përmban pesë histori të grave sipërmarrëse nga zonat e Pukës, Elbasanit dhe Kolonjës, me fokus tek sfidat e jetës së tyre të përditshme, familja, puna dhe koha e lirë. Të ndërgjegjshme se gratë janë aktore të rëndësishme në sektorin agro-ushqimor, nuk mund të ketë progres, nëse nuk fuqizojmë gratë të luftojnë varfërinë dhe përjashtimin social. Ndaj, është e rëndësishme të mbështesim dhe prioritojmë përpjekjet që përfshijnë dhe integrojnë barazinë gjinore në bujqësi dhe zhvillimin rural me synim ngushtimin e hendekut gjinor.

Blog: Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”- Midis dëshirës qeveritare dhe realitetit të fermerëve - dhjetor 2023

Në fillim të nëntorit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural filloi procesin e konsultimit për projektligjin “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”. Projektligji synon rritjen e mundësive të financimit në bujqësi përmes dy instrumenteve financiarë “dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm” dhe “dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar”. Në kuadër të procesit të konsultimit Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural përmes një procesi konsultativ me anëtarët e rrjetit dhe aktorë të tjerë relevantë ju drejtua ministrisë me disa komente dhe sugjerime, të cilat u pasuan nga ndarja e tyre në media dhe blogu [“Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”- Midis dëshirës qeveritare dhe realitetit të fermerëve.”](#)

Deklaratë-Asambleja e Parë Kombëtare e të Rinjve nga Zonat Rurale- 19 dhjetor 2023

Për të parën herë, rreth 100 të rinj nga komunitete të ndryshme rurale të Shqipërisë u mbledhën së bashku në [Asamblenë e Parë Kombëtare të të Rinjve nga Zonat Rurale](#), në kuadër të Parlamentit të tretë Rural Shqiptar zhvilluar nga 11 deri më 13 tetor 2023. Asambleja hodhi dritë mbi realitetet e ndryshme në të cilën gjenden të rinjtë në zonat rurale, me fokus të veçantë mbi sfidat dhe nevojat, si dhe aspiratat dhe endërrat e tyre për të ardhmen. Kjo asamble u pasua nga hartimi i Deklaratës së Asamblesë së Parë të të Rinjve nga Zonat Rurale. Kjo deklaratë është një thirrje për të kthyer dëshirën e të rinjve për të qëndruar dhe investuar në zonat rurale. Ne, sigurojmë se do të vazhdojmë të luajmë një rol aktiv dhe të kontribuojmë në proceset e zhvillimit rural dhe bujqësor me qëllim që këto të jenë të orientuara dhe të lidhura ngushtë me shqetësimet, interesat dhe prioritetet e të rinjve.

PARTNERITETE DHE RRJETËZIM 2023

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural është një organizatë e orientuar drejt rrjetëzimit si një nga mënyrat kryesore për të shkëmbyer njohuri dhe praktika të mira dhe për të vazhduar misionin tonë të përbashkët në përmirësimin e mirëqenies së banorëve të komuniteteve rurale.

“Qendra e Rinisë Rurale” bëhet anëtare e Rrjetit Evropian të Rinisë Rurale

Në gusht të vitit 2023 u zhvillua [Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian të Rinisë Rurale](#) (Rural Youth Europe). Në Asamble morën pjesë 23 organizata anëtare të cilat vinin nga njëzet vende të ndryshme të Evropës. Pjesë e rëndësishme e aktivitetit ishte shqyrtimi i kërkesave për t'u bërë anëtarë të RYE, një prej të cilave ishte edhe kërkesa për anëtarësim e Qendrës së Rinisë Rurale. Për këtë arsye, dy përfaqësues të RYH morën pjesë në Asamble për të prezantuar RYH, njohur me anëtarët e RYE dhe shkëmbyer më shumë mbi planet dhe vizionet e dy organizatave. Përfaqësuesit e RYH patën mundësinë të prezantonin organizatën, historikun e saj, aktivitetet kryesore dhe përforcuan kërkesën për anëtarësim në RYE. Në zbatim të rregullave për anëtarësim, Asambleja vendosi unanimisht që RYH të bëhet pjesë e Rrjetit Evropian të Rinisë Rurale si anëtarë kandidatë për dy vitet e ardhshme.

Vizitë shkëmbyese me përfaqësues të Grupit Vendor të Veprimit “Yerel Eylem Grubu Derneği”.

Më 10 shtator ANRD mirëpriti në [një vizitë shkëmbyese përfaqësues](#) të “Grupit Vendor të Veprimit Iskilip” nga Turqia. GVV “[Iskilip Yerel Eylem Grubu Derneği](#)” është themeluar në vitin 2014 në një partneritet mes përfaqësuesve të sektorit privat, publik dhe sektorit të shoqërisë civile për të siguruar zhvillim të rajonit rural përmes një qasje nga poshtë lart duke identifikuar problemet që ndikojnë në zhvillimin e Qarkut të Iskilip-it, prioritetet e zonës së tyre Leader dhe ndërhyrjet/projektet për zgjidhjen e problemeve. Ky takim shërbeu për të ndarë sfidat, praktikat e mira të funksionimit të Grupeve Vendore të Veprimit dhe përvojën në zbatimin e qasjes Leader.

PROMOVIMI I DY ÇMIMEVE NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM RURAL

Një nismë që i kushtohet nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të dy profesionistëve që kryesuan zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri. ANRD synon të krijojë një trashëgimi që nxit zhvillimin dhe progresin e vazhdueshëm të komuniteteve rurale shqiptare, duke vlerësuar udhëheqësit dhe duke krijuar një rrjet të personave që sjellin ndryshimin dhe më tej përforcojnë përpjekjet e tyre në nivel kombëtar dhe lokal.

Çmimi “Pier Paolo Ambrosi” - Për Lidërsip në Zhvillimin Rural

nderon kujtimin e kolegut tonë të dashur, Pier Paolo Ambrosi duke njohur dhe vlerësuar aktorët lokalë, të cilët tregojnë lidërsip dhe kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale në të gjithë Shqipërinë. Çmimi promovohet nga ANRD bashkarisht me VIS Albania çdo dy vjet, me rastin e Parlamentit Rural Shqiptar. Çmimi i parë (2023) u nda gjatë Parlamentit të Tretë Rural Shqiptar, të zhvilluar nga 11 deri në 13 tetor 2023.

Çmimi “[Pier Paolo Ambrosi](#)” – për Lidërsip në Zhvillimin Rural iu dha figurës së Agjentëve të Zhvillimit Lokal. Drita Tanazi mori këtë çmim në emër të gjithë AZHL-ve. Drita ia ka dedikuar jetën e saj zhvillimit të komuniteteve rurale. Teksa mban në duar çmimin “Pier Paolo Ambrosi”, Drita shprehet: “Unë jam lindur dhe rritur në Tamarë, Kelmend, në Malësinë e Madhe, një zonë e thellë malore në veri të Shqipërisë. Në vitin 2011 u njoha me Pier Paolo-n, përfaqësues i shoqatës italiane VIS Albania dhe që nga ai vit e deri më sot, unë jam pjesë e stafit VIS Albania si Agjente e Zhvillimi Lokal. Puna jonë është

t'i gjendemi afër komunitetit ku jetojmë, duke i dëgjuar, mirëkuptuar dhe ndihmuar ata. Roli i Agjentit të Zhvillimit Lokal nuk ka orare, nuk ka një vend pune të caktuar, nuk ka një rol të caktuar, ai është një vullnetar me zemër të madhe, që nuk lodhet kurrë. E tillë ndihem unë sot.”

Çmimi “Liljana Isakaj” - Për Lidërsip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale

Prezantimi i çmimit “Liljana Isakaj” - Për fuqizimin e Grave të Zonave Rurale është një nismë kushtuar nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të Liljana Isakajt, e cila ia kushtoi jetën zhvillimit rural dhe fuqizimit ekonomik të grave rurale. Si epitomë e grave rurale, Liljana hapi rrugën për progres, lidërsip dhe ndryshim pozitiv në komunitetet rurale. Ky çmim do të vlerësojë individë që kanë kryer përpjekje të jashtëzakonshme për të përmirësuar jetën e grave rurale. Çmimi do të promovohet nga ANRD së bashku me ADAD malore çdo vit me rastin e organizimit të Pro-Grave Rurale.

Çmimi i parë “[Liljana Isakaj](#)” - Për Lidërsip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale u nda gjatë Edicionit të pestë të ‘Pro-Grave Rurale’ të organizuar më 12 tetor 2023 dhe iu dha Pavlina Sumbullës. Pavlina ka punuar në Komunën e Vithkuqit për rreth 11 vite, periudhë kur ka nisur njohjen e saj me Liljanën dhe përfaqësues të tjerë të organizatës ADAD malore. “Liljana erdhi këtu për të formuar një grup të grave që ishin të angazhuara me prodhimin e produkteve lokale. Që prej vitit 2008 jam bërë pjesë e ADAD malore dhe kam qenë e pranishme në trajnime, panairë dhe shkëmbime eksperiencash që organizoheshin nga organizata. Ndihem e privilegjuar që kam njohur dhe kam patur mundësinë të punoj me një profesioniste siç ishte Liljana Isakaj.”

DALJE NË PUBLIK DHE KONTRIBUTE NË EVENTE TË RËNDËSISHME

Mbi rolin dhe sfidat e grave të përfshira në sektorin e bujqësisë – podcast Citizens Channel

Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj dhe Ledina Mici një nga anëtarët më aktive të grupit lokal të grave në Shirgjan të përfshirë në zinxhirin e vlerës së perimeve të freskëta, ishin të ftuara [në podcastin e Citizens Channel](#) mbi rolin dhe sfidat e grave të përfshira në bujqësi. Në këtë episod, ato ndanë përvojën dhe perspektivat e tyre në fuqizimin e grave në sektorin bujqësor, duke theksuar rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm që ato japin në bujqësinë e qëndrueshme dhe

komunitetet rurale. Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e tyre në një nga sektorët më të rëndësishëm të vendit tonë mbetet një fushë tematike e rëndësishme e përpjekjeve të ANRD për fuqizimin e grave dhe vajzave nga zonat rurale.

Forumi i Shoqërisë Civile për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2023 - Programi TACSO

Stafi kyç i ANRD mori pjesë në [Forumin e Shoqërisë Civile për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2023](#), organizuar nga TACSO (Asistenca teknike e BE për OSHC-të), i cili u zhvillua nga 31 maj deri më 1 qershor 2023 në Podgoricë. Me mbi 150 pjesëmarrës, kjo ngjarje vjetore shërbeu si platformë vendimtare për ndarjen e njohurive dhe zhvillimin e strategjive për të promovuar rritjen e shoqërisë civile në rajon.

Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj, dha kontribut të rëndësishme në grupin e punës të fokusuar në integrimin e diversitetit. Ajo ndau në panel përvojat dhe përpjekjet e ANRD në promovimin e zhvillimit rural me pjesëmarrje dhe nismave të advokacisë nga poshtë-lart duke ofruar një fokus të unifikuar të interesave dhe prioriteteve të komuniteteve rurale për të ndikuar institucionet publike dhe palët e tjera të interesit në dobi të fermerëve të vegjël, grave dhe të rinjve nga zonat rurale.

Takim konsultues me OSHC-të mbi Agjendën e Gjelbër- programi TACSO

ANRD mori pjesë dhe kontribuoi në takimin konsultues të organizuar me OSHC-të në rajonin e Ballkanit Perëndimor të organizuar nga TACSO më 21 shtator. Me pjesëmarrjen e më shumë se 60 OSHC-ve nga rajoni, Lira Hakani, menaxherja e projektit rajonal "Akademia nga Ferma në Tryezë për një Ballkan Perëndimor të Gjelbër - E ardhmja jonë e përbashkët evropiane" kontribuoi me prezantimin e saj. Lira prezantoi një përmbledhje të raportit të ["Vlerësimit të kapaciteteve të OSHC-ve për sistemet ushqimore dhe komunitete rurale të qëndrueshme për tranzicionin e gjelbër"](#). Projekti synon të kontribuojë në zbatimin e objektivit të pestë të Agjendës së Gjelbër, përmes forcimit të kontributit të shoqërisë civile në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Forumi i Politikave Bujqësore 'Drejt Partneritetit për Përshtatjen Klimatike në Evropën Juglindore' - SWG

Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj mori pjesë në Forumin e Politikave Bujqësore ['Drejt Partneritetit për](#)

[Përshtatjen Klimatike në Evropën Juglindore](#)' që u organizua në Podgoricë më 25 dhe 26 tetor 2023.

Zbatimi i qasjes LEADER në Ballkanin Perëndimor ishte tematika e prezantimit të Evelinës, në panelin kryesor të Forumit duke sjellë rastin e Shqipërisë në zbatimin e këtij instrumenti të politikës evropiane për zhvillimin e integruar vendor.

Përgjatë 20 viteteve të kaluara, udhëtimi i qasjes Leader në Shqipëri është një histori shprese nga njëra anë dhe lodhjes dhe pritshmërive të papërbushura të aktorëve vendor nga ana tjetër. Qasja LEADER, e cila fokusohet në zhvillimin e drejtuar nga komuniteti, zhvillimin e integruar dhe nga poshtë lart, mund të kishte qenë një nga instrumentet më të fuqishme për të adresuar sfidat e zhvillimit rural dhe rigjallëruar zonat rurale. Megjithatë, potenciali i plotë i qasjes Leader mbetet për t'u çliruar falë IPARD III dhe programeve të donatorëve të ndryshëm që po mbështesin Grupet Vendore të Veprimit.

Konferenca finale e “Strategjitë e Specializimit Inteligjent (S3)”

Nën kujdesin e Zëvendës Ministres Zj. Belinda Balluku u organizua Konferenca finale e S3 “Smart Specialization Strategy”, Shqipëria Inteligjente: Prioritetet dhe Vizioni për të Ardhmen për të diskutuar rezultatet e arritura deri më tani nga kjo strategji. Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj, mori pjesë si paneliste në diskutimin tematik [Zinxhiri Ushqimor i Shëndetshëm dhe i Qëndrueshëm](#), identifikuar nga S3 si një nga fushat me potencial për zhvillimin novator. Pavarësisht se bujqësia shqiptare është sektor novator dhe demonstroi kapacitete për novacion, ende potenciali që ka në këtë drejtim nuk është eksploruar dhe përdorur në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të sektorit." Ndër të tjera, Evelina u ndal në qasjen LEADER si një instrument efektiv i Politikës Evropiane për zhvillimin e integruar rural si dhe si një filozofi novatore për zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare e Bujqësisë dhe Shkencave të Jetës - UBT

Në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të Bujqësisë dhe Shkencave të Jetës të organizuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj kontribuoi si paneliste në [seancën plenare mbi të ardhmen e bujqësisë shqiptare në kontekstin e integritit evropian](#). Diskutimi u fokusua mbi sfidat e fermerëve, sipërmarrësve dhe komuniteteve rurale në rrugën drejt reformimit të sektorit bujqësor, rolin e komunikimit të procesit të integritit evropian, përpjekjet dhe progresin deri më tani. Për të garantuar suksesin e procesit të integritit evropian, është e rëndësishme që fermerët, agropërpunuesit, sipërmarrësit, dhe qytetarët të jenë të informuar mirë rreth procesit, instrumenteve, dhe përfitimeve si dhe të kontributeve të mundshme nga aktorë të ndryshëm.

Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore-SCAN TV

Kontributi në përmirësimin e projektligjeve dhe strategjive të publikura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për konsultim publik tashmë është një fushë programatike pune e vazhdueshme e ANRD dhe organizatave të veta. Në vijim të ndarjes së sugjerimeve dhe komenteve të unifikuara nga ANRD përmes kontributeve të organizatave anëtare mbi projektligjin “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore” me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, hulumtuesja e re e ANRD, Alba Tema ishte e ftuar në emisionin [Box to Box në SCAN TV](#). Gjatë kësaj bisede me gazetaren Ada Hazizolli ajo ndau komentet, sugjerimet dhe rekomandimet rreth projektligjit. Ky moment ishte një mundësi shumë e mirë për të dëgjuar perspektivën e ANRD rreth përparësive dhe sfidave të projektligji.

PROJEKTET 2023

Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjelbër – E ardhmja jonë e përbashkët evropiane 16 janar 2023 – 15 janar 2027

Projekti rajonal “[Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjelbër – E ardhmja jonë e përbashkët evropiane](#)” zbatohet nga konsorciumi i Rrjeteve Kombëtare të Zhvillimit Rural në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroaci si dhe nga platforma e tyre rajonale e bashkëpunimit, Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural. Ky projekt synon të forcojë kapacitetet e sektorit civil të angazhuar në zhvillimin rural dhe bujqësor në rajon për të qenë aktorë kyç në adresimin e sfidave të shoqërisë, në lidhje me ndryshimet klimatike dhe humbjet e biodiversitetit, veçanërisht në zbatimin e kuadrit strategjik evropian në nivel kombëtar dhe vendor, të Marrëveshjes së Gjelbër dhe Strategjisë `Nga Ferma në Tryezë`, si dhe mbështetjes së nismave të gjelbra dhe novatore për sisteme të qëndrueshme ushqimore. Për shumë më shumë informacion [Fact Sheet Farm to Fork Academy for Green Western Balkans – Shqip \(002\)](#).

“RURALBANIA: Nisma për mbështetjen dhe promovimin e produkteve bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale shqiptare” 1 shtator 2022 – 31 gusht 2025

RURALBANIA është një nismë për të mbështetur dhe promovuar produktet bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale shqiptare. Ndërhyrja mbështet autoritetet shqiptare dhe shoqërinë civile në zbatimin e Agjendës 2030, duke iu referuar Qëllimit Strategjik të Qëndrueshëm 2 dhe promovimit të bujqësisë së qëndrueshme (Target 2.3). Projekti gjithashtu mbështet rrugën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, në kuadër të së cilës përshtatja me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) përfaqëson një element themelor. Ndërhyrja synon të rrisë produktivitetin dhe vlerën e shtuar të arritur nga fermat familjare që operojnë në zinxhirë furnizimi me potencial të lartë në zonat malore të pafavorizuara të Shqipërisë së Veriut.

Kjo ndërhyrje tre-vjeçare fokusohet në zonat malore fqinje dhe homogjene të Shqipërisë verilindore dhe në zinxhirë të kufizuar prodhimi, për të maksimizuar ndikimin socio-ekonomik në komunitetet si më poshtë: - Rajoni Lindor i Shkodrës: bletari, fruta pylli 5 - Qarku i Kukësit: mbarështimi i deleve dhe dhive - Rajoni i Dibrës: pemë frutore.

Ruralbania financohet nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga Volontari nel Mondo RTM, në partneritet me CIA – Agricoltori Italiani, Rajoni Emilia Romagna, ADAD Malore, AgroPuka, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor dhe Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural.

“RINIA SHQIPTARE RURALE – RURAL YOU!” 1 shkurt 2021 – 31 tetor 2023

Projekti “Rinia Rurale Shqiptare” synon të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të komuniteteve rurale të Shqipërisë verilindore, përkatësisht në zonat e thella të Rajonit të Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Rezultatet e pritshme janë: i) Rritja e ndërgjegjësimit midis grupeve të synuara mbi rolin e të rinjve në reformën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri; ii) Rritja e aktivizmit të të rinjve për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale të synuara; iii) Konsolidimi i platformës Rural Youth Hub si një përvojë pilot për të angazhuar të rinjtë që jetojnë në zona të thella në veprimet e rrjetëzimit dhe dialogun e politikave. Rural-You është financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Volontari nel Mondo RTM, në partneritet ADAD Malore, AgroPuka, Partnership for Development Foundation, dhe

Association of Young Agricultural Entrepreneurs - Italian Confederation of Farmers.

“Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi”- 5 shtator 2022-20 dhjetor 2023

Projekti “[Fuqizimi i grave ne zonat rurale dhe turizmi](#)” financohet nga Qeveria Italiane dhe zbatohet nga UN Women Albania and FAO, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Projekti zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural në rolin e palës përgjegjëse për UN Women Albania. Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e situatës ekonomike të vajzave dhe grave në zonat rurale në bashkitë Elbasan dhe Kolonjë. Qasja që do të ndiqet në mbështetje të fuqizimit ekonomik dhe social të grave rurale do të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi duke mundësuar formalizimin e Grupeve Lokale të Veprimit bazuar në praktikat më të mira evropiane në zbatimin e qasjes Leader. Zbatimi i suksesshëm i LEADER, zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti dhe zhvillimi rural varet nga krijimi i një kuptimi të përbashkët mes aktorëve të interesit mbi zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe të parimeve që qëndrojnë në themel të qasjes LEADER.

TOKA JONË – Ripërdorimi i tokave të konfiskuara për të promovuar bujqësinë sociale

Janar 2022- shtator 2024

Projekti ‘[TOKA JONË](#)’ synon të forcojë sipërmarrjen sociale në menaxhimin e aseteve të konfiskuaranga organizatat kriminale bazuar në modelet e bujqësisë sociale. Qëllimi kryesor i ‘TOKA JONË’ është që të përcaktojë një model të bujqësisë sociale të qëndrueshme nëpërmjet trajnimit dhe punësimit të grupeve vulnerabël dhe të marginalizuara si dhe përfshirjes së komunitetit lokal në një sërë fushatash ndërgjegjëse. Për këtë qëllim, ‘TOKA JONË’ do të ofrojë mbështetje për iniciativa novatore të bujqësisë sociale përmes ripërdorimit të tokave të konfiskuara si një mjet për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik, mundësitë e punësimit të grupeve vulnerabël, ndjenjën e ligjshmërisë dhe sundimit të ligjit.

LIQENET E SHQIPËRISË – Promovimi i modeleve të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për zhvillimin gjithëpërfshirës të komuniteteve” 1 gusht 2022 – 31 korrik 2025

Projekti synon të promovojë modele novatore të turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në zonat që lidhen me dy

liqenet kryesore të Shqipërisë - Liqenin e Shkodrës dhe Liqenin e Pogradecit/Ohrit - në krahasim me modelet e turizmit invaziv dhe zhvillimit në zgjerim të fortë në të gjithë territorin shqiptar, me qëllimin për të kontribuar në një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse të Shqipërisë. Projekti “LAGHI D'ALBANIA” financohet nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) dhe po zbatohet nga COSV dhe VIS në partneritet me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), Shoqatën Italiane për Turizmin e Përgjegjshëm (AITR), Diosis Network, Kallipolis, Studio Azue, në bashkëpunim me Fondacionin ABC dhe Fondacionin Partneritet për Zhvillim (Pfd).

“Forcimi i partneriteteve për zhvillimin vendor përmes fuqizimit të rrjeteve kombëtare dhe rajonale të zhvillimit rural në Ballkanin Perëndimor”

“Forcimi i partneriteteve për zhvillimin vendor përmes fuqizimit të rrjeteve kombëtare dhe rajonale të zhvillimit rural në Ballkanin Perëndimor” është projekt që po mbështetet financiarisht nga projekti rajonal i GIZ “Mbështetje për diversifikimin ekonomik të zonave rurale në Evropën Juglindore (SEDRA)”. Qëllimi kryesor i këtij projekti është rritja e potencialeve të punësimit dhe të ardhurave në zonat rurale në vendet e Evropës Juglindore. Mbështetja ka në fokus rritjen e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencës, forcimin e kapaciteteve të aktorëve kryesorë për të ndërtuar një model funksional nga poshtë-lart për zhvillimin rural me pjesëmarrje dhe zbatimin e zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti dhe qasjen LEADER.

Agroekologjia - ANRD ka qenë partneri kombëtar i Schola Campesina në Itali në përdorimin e TAPE – [Mjet për Vlerësimin e Performancës Agroekologjike](#) – që përfshin 12 vende të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore të mbështetur nga FAO REU për të studiuar përvojat e agroekologjisë në nivel vendor. Falë këtij bashkëpunimi, ANRD po përpiqet të promovojë agroekologjinë dhe të lehtësojë shkëmbimin e njohurive lokale në lidhje me praktikën e agroekologjisë në nivel vendor, për të bërë në të ardhmen funksionale ‘shkollën’ e agroekologjisë – një shkollë pa mure, pa infrastrukturë shkollore, por që përmbledh aktivitete të shkëmbimit të njohurive dhe praktikave ndërmjet fermerëve dhe aktorëve të tjerë.

ANËTARËT E RINJ 2023

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural mbetet e hapur ndaj zgjerimit të anëtarësisë dhe përfaqësimit të komuniteteve rurale në të gjithë vendin, deri në zonat më të thella malore. Gjatë viti 2023 ANRD-së iu bashkuan tre organizata të reja anëtare: Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore-Agri-En, Shoqata e Përdoruesve të Burimeve Natyrore Velçan dhe Shtëpia e Bariut dhe Bjeshkimit.

Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore-Agri-En

[Agri-En](#) është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në vitin 2014 në Librazhd nga një grup specialistësh që punuan për hartimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Agri-En e ka fokusuar aktivitetin e saj në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale përmes vënies në zbatim të kompetencës tekniko-shkencore dhe operative në sektorët lidhur me burimet njerëzore dhe bujqësinë, turizmin etj. Përgjatë nëntë viteve Agri-En ka investuar në asistencë teknike dhe rritjen e kapaciteteve për anëtarët e saj dhe aktorë të tjerë vendorë, ka bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare dhe kombëtare si UNDP, PONT, CEPF, INCA, REC, PPNEA, Co-PLAN, me institucionet publike duke mbështetur fermerët e zonës me mjete pune, farëra, fidanë etj. Agri-En ka zbatuar 11 projekte në bashkitë Librazhd dhe Prrënjas duke promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, në zhvillimin e bujqësisë dhe fuqizimin e sektorit të bimëve medicinale, frutave etj.

Shoqata e Përdoruesve të Burimeve Natyrore Komunës Velçan, Pogradec

[SH.P.B.N.NJ.Velçan](#) është një organizatë jo-qeveritare e themeluar në vitin 2009 në Velçan, Pogradec. Kjo shoqatë u themelua nga një grup specialistësh që punuan për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Pyjeve në kuadër të projektit të Bankës Botërore. Shoqata është e vendosur në Pogradec dhe e ka të shtrirë aktivitetin në fushën e pyjeve, mjedisit, bujqësisë dhe agroturizmit duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale të Pogradecit, kryesisht krahinës

Mokër-Gorë. SH.P.B.N.NJ. Velçan punon fort për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të saj dhe aktorëve të tjerë lokale përmes bashkëpunimit me organizata të ndryshme dhe institucione publike. Disa nga projektet kryesore në të cilat është angazhuar organizata janë Projekti i Bankës Botërore të Pyjeve, Projekti i shërbimeve Mjedisore zbatuar nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, duke mbështetur anëtarët me farëra, fidanë, dhe ndihmë mbështetëse për mbrojtjen dhe rigjenerimin e pyjeve si dhe ndërtim e lerave për blegtorinë.

Shtëpia e Bariut dhe Bjeshkimit, Kelmend

Shtëpia e Bariut dhe Bjeshkimit është bashkimi i dy entiteteve: shtëpia e bariut dhe ajo e bjeshkimit, të dyja të bazuara në emërtime evropiane. Anëtarët e shoqatës janë mbarështues të bagëtive, ekspertë në bujqësi, në fushën e mjedisit dhe shkencave njerëzore, operatorë kulturorë, përfaqësues të qeverisë vendore të interesuar në mbrojtjen e transhumancës.

Qëllimi i kësaj organizate është ruajtja dhe zhvillimi më tej i transhumancës si një nga pasuritë më të mëdha kulturore të Shqipërisë, tashmë marrë nën mbrojtjen e UNESCO. Gjithashtu aktiviteti i organizatës është i fokusuar në mbështetjen e komuniteteve baritore për të shprehur dhe unifikuar problemet dhe nevojat e tyre. Shtëpia e bariut dhe bjeshkimit shërben si një trup vëzhgues dhe ruajtës i pastoralizmit dhe praktikës së transhumancës si dhe advokues për përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve baritore.



MEDIAT SOCIALE

Karakteristikat demografike të ndjekësve

Figura 1. Ndjekësit e faqes së ANRD sipas gjinisë në vitin 2023





Figura 2. Ndjekësit e faqes së ANRD sipas moshës në vitin 2023



Gjatë vitit të kaluar 52% e ndjekësve të ANRD ishin meshkuj dhe 48% e tyre femra. Përsa i përket moshës pjesa më e madhe e tyre i përket grupmoshës 25-34 vjeç (35.2%), ndërsa grupmosha që zë përqindjen më të ulët është mbi 65 vjeç me rreth 4.9%.

Mediat Sociale

Karakteristikat demografike të ndjekësve



Figura 3. Ndjekësit e faqes së ANRD sipas qyteteve në vitin 2023






Figura 4. Ndjekësit e faqes së ANRD sipas vendeve në 2023



Pjesa më e madhe e ndjekësve të faqes së facebook të ANRD janë nga Tirana (36%), Shkodra (5%) dhe Përmeti (4%). Pas ndjekësve nga Shqipëria (76%), ndjekësit nga Italia zënë pjesën më të madhe me 6%, ndjekur nga Kosova me 4%.

Figura 5. Statistika mbi postimet e ANRD në vitin 2023



Në vitin 2023 : 633 ndjekës të rinj dhe rritje të pëlqimeve me 29.7%.



POSTIMET MË POPULLORE TË 2023:

1-Krijimi i Qendrës së Artizanatit në Kavajë- 10 janar 2023

#Së shpejti në #BashkiaKavajë do të funksionojë #QendraZhvillimittëArtizanatit.

Të lumtur që sot me #BashkiaKavajë, Gjumnazi "Aleksander Moisiu" dhe Grupi i formalizuar i #graveartizane arritëm të finalizonim e #Marrëveshjes së #Mirëkuptimit "Për Ngritjen dhe Funksionimin e Qendrës së Artizanatit në Bashkinë Kavajë".

4,046 shikime, 88 reagime, 7 komente, 14 ndarje

2- Video në kuadër të promovimit të rolit të grave në zonat rurale- 7 mars 2023

*Një ditë larg nga Dita Ndërkombëtare e Gruas, po ndajmë me ju një video mbi rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të grave dhe vajzave në zonat rurale të Shqipërisë. Ky është një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi **situatën sociale dhe ekonomike, sfidat dhe veshtirësitë e jetës së përditshme** të grave dhe vajzave për të siguruar mirëqenie të komuniteteve rurale, sipërmarrjeve dhe familjeve të tyre.*

2,827 shikime, 100 reagime, 1 koment, 6 ndarje

3- Parlamenti i Tretë Rural- 11 Tetor 2023

Çfarë atmosfere entuziaste në Parlamentin e Tretë rural Shqiptar!!!

Ky ishte parlamenti i të gjithëve, #fermerëvetërinj, #blegtorëve, #bjeshkëtarëve, #fermerëve të vegjël dhe #fermavefamiljare, #grave në bujqësi dhe agroushqim që morrën pjesë në #Pro-GraveRurale2023, i #sipërmarrësve novator, i #vajzave që veshin me krenari #xhuletën, i #lahutarit dhe #sofrës së malësorit që lancuan vitin ndërkombëtar të kullotave #IYRP, i të #rinjve nga zonat rurale që morrën pjesë në #Asamblejaeparëtetërinjve, #OSHClokale #shoqatave #prodhuesit #NJVV etj.

2,288 shikime, 60 reagime, 1 koment, 5 ndarje

PASQYRAT FINANCIARE
2023

Të ardhurat dhe shpenzimet

Tabela 2. Të ardhurat dhe shpenzimet e ANRD për periudhën Janar- Dhjetor 2023

	2023	Totali 2022
TE ARDHURAT		
708 Te ardhura te tjera		
73 Grante	12,748,213	39,660,915
731 Kuota anëtarësimi	35,000	35,000
Totali i të ardhurave	12,793,213	39,695,915
SHPENZIMET		
Shpenzime të tjera	1,108,618	116,137
Qira zyre	475,927	470,570
Ekspertë të jashtëm	3,309,605	1,358,161
Shpenzime aktivitetesh (Qira/salle)	5,894,419	1,666,653
Udhëtim, Dieta & Transport	1,118,294	607,871
Taksa e Tarifa Vendore	30,000	15,000
Nëntrajtime / Përkthime	3,653,943	667,274
Paga	11,000,261	3,033,571
Kontribute shoqërore, shëndetësore, TAP	1,457,705	316,752
Energji, Ujë & riparime dhe mirëmbajtje	177,162	211,973
Shpenzime Telefoni, Postare etj.	112,266	589,790

	2023	Totali 2022
Grante të transferuara partnerëve	12,383,688	
Efektet e kursit të këmbimit	1,042,984	-168,931
	Lek 41,797,582	Lek 8,884,821

Figura 6. Paraqitje grafike e të ardhurave dhe shpenzimeve




Figura 7. Numri i stafit të ANRD në 2022 dhe 2023




Figura 8. Numri i projekteve te menaxhuara 2022 - 2023




Figura 9. Fonde te menaxhuara 2022 - 2023





Figura 10. Fondet sipas donatoreve 2023



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

	2023	Totali 2022
AKTIVET		
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre		
Të arkëtueshme		
Të arkëtueshme	5,000	1,038,045
Gjendje Arke	9,248	18,594
Gjendje Banke	3,531,225	30,475,363
Total Arkë dhe Bankë	3,540,473	30,493,957
Asete afatgjata		
Mobilier & Pajisje zyre	194,098	
Amortizim i pajisjeve	-22,228	
Totali i aseteve afatgjata	171,870	
Total Assets	Lek 3,717,343	Lek 31,532,002
DETYRIMET		
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	932,415	13,368
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore / shëndetësore	356,429	132,560
Të pagueshme për detyrimet tatimore	51,073	28,279
Të tjera	649,158	625,158
Totali i të pagueshmeve	1,989,075	799,365
Grante të marra në avancë	1,728,268	30,732,637
Totali i Detyrimeve	3,717,343	31,532,002

Tabela 4. Projektet e zbatuara nga ANRD gjatë viteve 2022 dhe 2023

Nr.	Titulli projektit	Donator	Periudha e implementimit	Buxheti në Lek	2022	2023
1	<i>Nisma për mbështetjen dhe promovimin e produkteve bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale Shqiptare - RURALBANIA</i>	AICS	Tetor 2022 – Shtator 2025	7,962,570	x	x
2	<i>Lagi D’Albania: Promozione di modelli di turismo sostenibile e responsabile per lo sviluppo inclusive delle comunita</i>	AICS	Shkurt 2023 – Korrik 2025	2,739,000	x	x
3	<i>RURAL ALBANIAN YOUTH [RURAL-YOU]</i>	AICS	Janar 2021 – Janar 2024	4,138,746	x	x
4	<i>"TOKA JONË - re-use of confiscated land to promote social agriculture"</i>	EU	Dhjetor 2021 – Dhjetor 2024	5,782,827	x	x
5	<i>Support to women artisans in the municipalities of Kavaja and Kruja in handicrafts value chain</i>	UN	Qershor 2022 – Mars 2023	5,180,500	x	x
6	<i>"Support the economic and social empowerment of rural women in the municipalities in Elbasan and Kolonje</i>	UN	Shtator 2022 – Tetor 2024	20,162,645	x	x
7	<i>Farm to Fork Academy for Green Western Balkans – Our shared European future</i>	EU	Janar 2023 – Dhjetor 2027	167,293,247		x
8	<i>Strengthened networking in Western Balkans for socio-economic development of rural areas</i>	GIZ	Nëntor 2022- Qershor 2024	3,690,465		x
9	<i>Cultivating Entrepreneurship in the AgriFood Sector through VET</i>	EU – ERASMUS +	Dhjetor 2023 – Nëntor 2026	3,317,380		x